



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 541/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.11.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Evita” shpk, “OES Distrimed” shpk, “Montal” shpk dhe “Farma Net Albania” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr.REF-65289-07-13-2020, me objekt “*Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale për përballimin situatës së Covid-19*”, me fond limit 599,940,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe kërkon nga KPP të marrë një vendim deklarativ në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund ta dëmshpërblejë për shkak se kanë pësuar humbje si rezultat i shkeljes së ligjit.

Ankimues: “Intermed” shpk
Rruga Ismail Qemali 12/1 Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Subjekt i Interesuar: “Farma Net Albania” shpk
Rruga “Siri Kodra”, Tiranë

“OES Distrimed shpk
Blv “Bajram Curri”, Tiranë, A

BOE “Montal” shpk& “Biometric” shpk
Rruga “Dervish Hima”, 3 Kullat, K.3, Ap 9/2 Tiranë

“Evita” shpk
Autostrada Tirane-Durres, Km.8, Rruga "Paralele",
Ndertese Private, Kashar Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e

prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 13.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-65289-07-13-2020, me objekt “Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale për përballimin situatës së Covid-19”, me fond limit 599,940,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 28.09.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 02.11.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

-	Ë.Center	pa ofertë	I skualifikuar
-	Eltian 2009	pa ofertë	I skualifikuar
-	Farma Net Albania	119,365,500	I kualifikuar
-	Trimed	158,578,191.45	I skualifikuar
-	Montal	178,448,700	I kualifikuar
-	Euromed	189,910,000	I skualifikuar
-	OES Distrimed	200,233,400	I kualifikuar
-	Evita	303,215,000	I kualifikuar
-	Fufarma	319,999,800	I skualifikuar
-	Intermed	359,533,908	I kualifikuar
-	Malbertex	374,828,400	I skualifikuar

- G&F Group 511,106,000 I skualifikuar

II.4. Në datën 06.11.2020 operatori ekonomik “Intermed” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në datën 02.11.2020 u njohë me vlerësimin për tenderin objekt ankimi. Konkretisht objekti i këtij ankimi ka të bëjë me fazën e vlerësimit për tenderin Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale për përballimin e situatës së Covid 2019 të datës 02.11.2020. Pranimi i ofertave dhe kuotimi i operatorëve ekonomikë me vlerë më të ulët është në kundërshtim me parimet e kriteret ligjore të prokurimit publik dhe është diskriminues.
- Më datë 17.09.2020 në sqarim për modifikim në DST (3) të procedurës së prokurimit me objekt Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale për përballimin e situatës së Covid 2019” për shkak të cilave afati i dorëzimit të ofertave është shtrë deri më datë 28.09.2020. Në modifikimin nr.3 citohet: Në shtojcën 9 pikë II e DT Kriteret e vecanta të kualifikimit të procedurës së sipërcituar bëhet ndryshimi i mëtejshëm si më poshtë vijon:

Hiqet kriteri në pikën 9 : Operatori ekonomik duhet të vetdeklarojë se disponon gjendje në RSH jo më pak se 10% të sasisë së artikujve objekt i kësaj procedure prokurimi.

Përsa i përket këtij ndryshimi në këtë fazë të tenderit e konsiderojmë të padrejtë dhe abuzuese. Ne duke përmbushur me përpikmëri kriteret e vecanta të kualifikimit të DT gjithashtu kemi marrë masa dhe për përmbushjen e pikës 9 në shtojcën pikë II të DT në lidhje me sigurimin e 10% të sasisë së artikujve objekt i kësaj procedure prokurimi në RSH që më datë 08.09.2020 data zyrtare e përcaktuar në modifikimin nr.1 për dorëzimin e ofertës e pastaj më datë 18.09.2020 e përcaktuar si datë përfundimtare me modifikimin nr.2.

Heqja e kriterit në pikën 9 kriteret e vecanta të kualifikimit me modifikimin nr.3 të publikuar në faqen zyrtare të APP më datë 16.09.2020 dy ditë para datës së hapjes së ofertave është qartë abuzive duke i hapur rrugë operatorëve të tjerë të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kriter paraprakisht të marrin pjesë dhe të renditen të parët në renditje. Kjo është qartë e dukshme që ndryshimi në DT ka ndodhur nga kërkesat e OE të interesuar sic citohet edhe në sqarimin për modifikimin në DT.

Në bazë të nenit 20 të LPP autoritetet duhet të shmangin cdo kriter , kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo ndaj kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Në rastin konkret nëpërmjet modifikimit nr.3 në pikën 9 të DT AK ka përjashtuar nga detyrimi për depozitimin e vetëdeklaratës me shkrim për përmbushjen e 10% të sasisë nga operatorët ekonomikë dy ditë para hapjes së ofertave duke i hapur rrugë konkurimit të atyre operatorëve të cilët nuk e kishin plotësuar këtë kriter në datën e mbylljes së kësaj procedure.

Ndërsa ne të cilët e kemi plotësuar kriterin 9 e kemi ngarkuar vetdeklartën me shkrim për 10% në sistemin elektronik një ditë para hapjes së ofertave dhe e kemi siguruar mallin në magazinë na shkaktohet një dëm ekonomik dhe një kosto financiare jo të vogël

duke na vendosur në të njëjtat kushte me kompani të tjera të cilat këtë kriter mund të mos e plotësojnë dhe njësoj të gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në këtë procedurë. Është risk jo i vogël financiar për një operator ekonomik të sigurojë paraprakisht këtë sasi para se të marrë pjesë në tender duke mos pasur siguri që do dalë fitues.

- *Gjithashtu duke ju referuar vlerësimit të kryer nga autoriteti kontraktor bazuar në dyshime të arsyeshme përvec shkeljeve të përmendura më sipër të cilat në thelb çënojnë parimin e barazisë transparencës dhe mosdiskriminimit autoriteti kontraktor ka kualifikuar në kundërshtim me nenin 46, 53, 55 të LPP operatorët ekonomikë Evita shpk, OES Distrimed shpk, Montal shpk dhe Farma Net shpk të cilët nuk përmbushin kriteret e vecanta të kualifikimit.*
- *Së pari duke qenë se shoqëria jonë ka qenë një shoqëri lider në treg dhe vecanërisht në furnizimin e sektorit privat dhe publik gjatë periudhës së pandemisë me pajisje e masa mbrojtëse si edhe duke patur njohur të thelluara të tregut ngrejme dyshimet tona që shoqëritë e kualifikuara nuk kanë dëshmuar se disponojnë dëshmi të eksperiencës së ngjashme në masën 40 % e vlerës së fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit. Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të procedurës së prokurimit si dhe kapacitetin e shoqërive të kualifikuara pasi kemi investiguar në bilancet e tyre mbi volumin e shitjeve dhe të ardhurat nga aktiviteti si dhe njohurive që disponojmë nga studimi i tregut e mendojmë të arsyeshme nga ana jonë ngritjen e dyshimeve që asnjë prej tyre nuk disponon kontratë të ngjashme në vlerën e kërkuar.*
- *Krahas këtij elementi mendojmë se synimi bazë i AK është blerja e mjeteve mbrojtëse të cilat janë të sigurta dhe përmbushin kërkesat e cilësisë së autoritetit kontraktor. Duke njohur produktet e këtij lloji që këto shoqëri tregëtojnë në tregun tonë mendojmë që produktet e ofertuara nga ana e tyre nuk përmbushin Certifikatat e Konformitetit sipas direktivës **MDD 93/42EEC** të kërkuar nga autoriteti kontraktor për rrjedhojë kjo certifikatë nuk është dorëzuar.*
- *Gjithashtu në katalogët e dorëzuar të cilat as nuk janë dorëzuar në përputhje me kriteret e tenderit ku specifikisht thuhet që : Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. **Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar.** (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe). Si rrjedhojë produktet e ofertuara nuk mund të përmbushin specifikimet teknike sipas DT.*

Sa më sipër kërkohet nga AK që të verifikohen të gjitha sa më sipër cituar në lidhje me plotësimin e standartit të kërkuar në dokumentat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë të sipërpërmendur.

*Rishkimin e veprimeve të AK që kanë cënuar parimin e barazisë , mosdiskriminimit dhe shkaktuar dëm financiar në kohë të vështirë dhe pandemie operatorëve ekonomikë.
Skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë të cilët janë renditur si oferta të suksesshme në fazën e vlerësimit të tenderit.*

II.5. Në datën 10.11.2020 me shresën nr.3324/39 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 19.11.2020 pala ankimuese “Intermed” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor duke kërkuar njeherazi edhe marrjen e një vendimi deklarativ në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë OE ankimues për shkak se ka pësuar humbje si rezultat i shkeljes së ligjit.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.3324/42 prot datë 25.11.2020 protokolluar me tonën me nr.1542/4 prot datë 25.11.2020 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Intermed” shpk mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Farma Net Albania” shpk me argumentin se *Duke njohur produktet e këtij lloji që këto shoqëri tregëtojnë në tregun tonë mendojmë që produktet e ofertuara nga ana e tyre nuk përmbushin Certifikatat e Konformitetit sipas direktivës MDD 93/42EEC të kërkuar nga autoriteti kontraktor për rrjedhojë kjo certifikatë nuk është dorëzuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën “modifikim nr.2 mbi dokumentat e tenderit”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

Në Shtojcën 9, pikë II të DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të procedurës së sipërcituar bëhet ndryshimi i mëtejshëm si më poshtë vijon:

ISHTE:

5. “Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC (të përditësuar) ose sipas normës EU 2016/425, (të përditësuar), për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre përkatës, të përkthyer dhe të noterizuar.

BËHET:

5. “Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC (të përditësuar) ose sipas normës EU 2016/425, (të përditësuar) ose FDA për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre përkatës, të përkthyer dhe të noterizuar.

III.1.2. Në shtojcën 10 ”Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Specifikime	Njesia
1	<i>Cizme plastike mbrojtese</i>	<i>Cizme plastike mbrojtese</i>	<i>Pale</i>
2	<i>Doreza Nitrili madhesia M pa puder</i>	<i>sterile, pa puder ngjyre blu ose lejla me trashesi 0.12 mm (kuti me 100 cope), duhet te jene me te trasha se sa normalet per pune ne laborator Masa M</i>	<i>Kuti</i>
3	<i>Maska respiratore FFP3/FFP2 (N95)</i>	<i>Maske respiratore FFP2 (N95) me nje perdorim, hipoalergjike, pa fibra qelqi, pershkueshmeri te mire te ajrit, me nivel filtrimi te ajrit >= 95%, e perputhshme me fytyren dhe hundën, e certifikuar NIOSH 95 ose te plotesojne EN 149:2001</i>	<i>Cope</i>
4	<i>Syze mbrojtëse</i>	<i>Material polietilen me densitet të lartë, me kornizë fleksibël PVC që përshtatet lehtësisht me të gjitha konturet e fytyrës me presion të barabartë, për mbrojtjen e syve dhe zonën përreth tyre, që puthitet me lëkurën e fytyrës, lehtësisht I pastrueshëm, rezistent ndaj gërvishjeve dhe avujve, me shirit rregullues për tu siguruar shtrëngimin në mënyrë që të mos lirohet gjatë veprimtarisë klinike, Të ripërdorshme kundrejt kundrejt ndjekjes së rregullave përkatëse për dekontaminimin. Të jetë në</i>	<i>Cope</i>

		<i>përputhje me EN 166/ ANSI/ISEA Z87.1 ose ekuivalent.</i>	
5	<i>Veshje e padepërtueshme brendshme/jashtme me një përdorim</i>	<i>Veshje personale, jo të endura, me një përdorim, e përbere nga bluza dhe pantallonat. Bluza duhet të jetë me mëngje të shkurtra, pa kopsa ndërsa pantallonat duhet të jenë të gjata deri tek kyçet dhe me lidhese rreth belit.</i>	<i>Cope</i>
6	<i>Kapuc mbulues i kokës, qafës</i>	<i>Perdoret për mbrojtjen e kokës, qafës dhe të supeve. Me një përdorim, rezistent ndaj lëngjeve të ndryshme të trupit. Të garantojë mbrojtje kundër lëngjeve dhe produkteve biologjike dhe kimike të rrezikshme dhe agjentëve viralë dhe mikrobialë. Të jetë lehtësisht e adoptueshme në kokë dhe e palevizueshme. Pjesa e pasme dhe anësore të kapuçit të mbulojë shpatullat. Pjesa e përparme e kapuçit të arrijë deri në pjesën e sipërme të perparës ose kominosheve dhe të jetë e hapur në pjesën e fytyrës.</i>	<i>Cope</i>
7	<i>Kostum veshje spitalore</i>	<i>Veshje komplet me kapuc (kominoshe-tyvek) me masë XL dhe L.</i>	<i>Cope</i>
8	<i>Ekran mbrojtës i fytyrës</i>	<i>Ekran mbrojtës për fytyrën. Materiali i ekranit duhet të lejojë një shikim të qartë, të ketë mundësi rregullimi që të mund të pershtatet dhe ngjeshet mirë me kokën. Të mbulojë plotësisht fytyrën dhe pjesët anësore të saj. Të jetë një përdorimëshme. Të plotësojë standartin EN 166/2002</i>	<i>Cope</i>
9	<i>Doreza të gjata jo sterile, nitrile</i>	<i>Doreza të gjata jo sterile, nitrile me gjatësi jo më pak se 230 mm, me ngjyrë</i>	<i>cope</i>

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Farma Net Albania” shpk shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Letër Autorizimi datë 07.08.2020 për atë që është i interesuar : Ne Gezer Ayakkabi deri Sanayi Ve Tic A.S autorizojmë Farma Net Albania shpk të marrë pjesë në tendera të importojë dhe tregëtojnë produktet tona në Shqipëri.
- Certifikatë Cilësie e tipit CE Nr.dokumentit 2163-PPE-732 shoqëria anonime “Gezer Ayakkabi Deri Sanay Ve Ticaret”, vendi i prodhimit Organize Sanyi Bolgesi 116 Ada/Parsel/Bolu/Turkiye prodhon **Këpucë të sigurta cilësore** sipas standarteve TS EN ISO 20345:2013. Aprovohet në përmbushje të kushteve të përgjegjësive lidhur me kategorinë e II e cila mbështetet në Certifikatën e Cilësisë të tipit AT (CE) dhe në Direktivën e Pajisjeve Mbrojtëse të Individit (**89/686 EEC**) të hartuara në përputhje me standartet. Prezantimi i produktit Marka Gezer 262 D Model- Këpucë të sigurta e cilësore të përbëra nga material PVC Kategoria S4 Projekti D Klasa e II SRC. Përputhja me kërkesat themelore është pasqyruar në raportin teknik me nr.KKD-2163 745. Sipas tij prodhimi/prodhimet e firmës së përmendur në këtë dokument kur kërkohet Marka e konformitetit CE janë licensuar për të vendosur Marka e Konformitetit CE mbi produktet e tipit të miratuar në përputhje me udhëzimet përkatëse të direktivës së ndryshuar 89/686 EEC. Ky dokument i cili është i vlefshëm për një periudhë kohore 5 vjecare pa patur asnjë ndryshim që do të ndikonte në realizmin e shëndetit bazë dhe në sigurimin e tij mbështetet në standartet që lidhen me direktivën 89/686 EEC.
- Autorizim datë 09.09.20120 lëshuar nga F-L Gega prodhues i veshjeve njëpërdorimshe mbrojtëse për personel mjekësor me anë të kësaj deklarate deklarohet se Farma Net Albania shpk është i autorizuar eskuzivisht të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me Nr.Ref-65289-07-13-2020 për të paraqitur ofertë , të negociojë dhe të nënshkruajë kontratë për produktet e prodhuara nga kompania jonë si dhe të shpërndajë produktet tona për të gjithë teitorin e Shqipërisë.
- Certifikatë Konformiteti lëshuar nga AQScert Për sistemin e menaxhimit të cilësisë për kompaninë F-L Gega shpk sipas standartit EN-ISO 9001:2015 për fushat e aktivitetit si vijon: Prodhimi i materialeve mbrojtëse njëpërdorimshe për stafin mjekësor (sterile dhe josterile) dhe materiale njëpërdorimshe për kirurgji sterile (sete , beze, përparëse).
- Certifikatë Konformiteti lëshuar nga AQScert Sigurimi i cilësisë së prodhimit-Direktiva e pajisjeve medicinale 93/42/EEC shtojca V me numër certifikatë AQSDM/50852020 për kompaninë F-L Gega shpk referuar Direktivës dhe Annex 93/42/EEC Medical Devices Directive-Annex V. Prodhimi i materialeve mbrojtëse njëpërdorimshe për stafin mjekësor (sterile dhe josterile) dhe materiale njëpërdorimshe për kirurgji sterile (sete , beze, përparëse). AQSCERT deklarohet se kërkesat e shtojcës V të direktivës 93/42/EEC janë përmbushur për produktet e listuara Prodhimet e lartpërmendura zbatojnë një sistem të sigurimit të cilësisë i cili është subjekt i auditimeve të mbikqyrjes periodike të përcaktuara në shtojcën V, seksioni 4 të direktivës së lartpërmendur.

Përgjegjësia e AQSCERT për pajisjet e klasës 1 të mbuluara nga certifikata CE është e kufizuar në çështje prodhuese ose të lidhura me ruajtjen dhe mbajtjen e sterilitetit nëse pajisjet janë sterile , për çështjet e prodhimit që lidhen me konformitetin e produkteve me kërkesat metrologjike nëse ka funksion matës. Kjo certifikatë mbetet si pronë e organizimit ndërkombëtar të certifikimit dhe trajnimit AQSCERT të cilat duhet ti rikthehet kur është e nevojshme. Kompania e sipërpërmendur duhet të njoftojë të gjitha ndryshimet në lidhje me produktet e aprovuara tek AQSCERT.

- Deklaratë Konformiteti lëshuar nga F-L Gega kujt mund ti interesojë F-L Gega deklaron nën përgjegjësinë e saj në cilësinë e prodhuesit të veshjeve mbrojtëse kirurgjikale sterile dhe jo sterile se produktet e saj përputhen plotësisht me rregullat e mëposhtme Rregullore për PPE (EU) 2016/425 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 9 Marsit 2016 Për Pajisjet e mbrojtjes personale duke amenduar Direktivën e Këshillit 89/686/EEC. Produktet Kapuc Mbrojtës, Veshje personale

II.1.3. Në nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.. [...]*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 6 gërma “c” e VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. [...]*”

III.1.5. Në nenin 30 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë”.*

III.1.6. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor për të gjitha produktet objekt prokurimi ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të parqesin Certificate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC (të përditësuar) ose sipas normës EU 2016/425, (të përditësuar) ose FDA për të gjithë artikujt e ofruar. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Farma Net Albania shpk në përmbushje të kriterit rezulton se për artikullin nr.1 Cizme është dorëzuar dokumentacion i prodhuesit Gezer Ayakkabi deri Sanayi Ve Tic A.S. Prodhuesi ka lëshuar për operatorin ekonomik Farma Net Albania një letër autorizimi për të marrë pjesë në tendera si dhe të importojë dhe tregëtojë produktet e kësaj shoqërie në Shqipëri. Gjithashtu konstatohet se është dorëzuar Certificate Cilësie e tipit CE Nr.dokumentit 2163-PPE-732 shoqëria anonime “Gezer Ayakkabi Deri Sanayi Ve Ticaret”, vendi i prodhimit Organize Sany Bolgesi 116 Ada/Parsel/Bolu/Turkiye i cili prodhon **Këpuçë të sigurta cilësore** sipas standarteve TS EN ISO 20345:2013. Aprovohet në përmbushje të kushteve të përgjegjësive lidhur me kategorinë e II e cila mbështetet në Certificate të tipit AT (CE) dhe në Direktivën e Pajisjeve Mbrojtëse të Individit **(89/686 EEC)** të hartuara në përputhje me standartet.

KPP gjykon se operatori ekonomik Farma Net Albania shpk shfaq mangësi në përmbushjen e kërkesës së autoritetit kontraktor lidhur me dorëzimin e Certificate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC (të përditësuar) ose sipas normës EU 2016/425, (të përditësuar) ose FDA për artikullin nr.1 cizme. Sikundër pasqyruar më lart KPP vëren se certificate e konformitetit e lëshuar nga kompania prodhuese për produktin nr.1 cizme dëshmon se Organize Sany Bolgesi 116 Ada/Parsel/Bolu/Turkiye prodhon **Këpuçë të sigurta cilësore** sipas standarteve TS EN ISO 20345:2013. **Aprovohet në përmbushje të kushteve të përgjegjësive lidhur me kategorinë e II e cila mbështetet në Certificate të tipit AT (CE) dhe në Direktivën e Pajisjeve Mbrojtëse të Individit (89/686 EEC) të hartuara në përputhje me standartet.** Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik Farma Net Albania nuk provon se artikulli nr.1 cizme është i prodhuar nga prodhuesi në përputhje me direktivat e kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit MDD 93/42 EEC (të përditësuar) ose sipas normës EU 2016/425, (të përditësuar) ose FDA por në bazë të direktivës së Pajisjeve Mbrojtëse të Individit (89/686 EEC), akoma më tej, direktivë e cila rezulton e shfuqizuar, duke qënë kështu në kushtet e mospërmbushjes së kriterit të kualifikimit si dhe duke mos krijuar bindjen se po ofron produkte cilësore në përputhje me direktivën e kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Gjithashtu KPP nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Farma Net Albania shpk vëren se për produktin me nr.5 veshje personale dhe nr.6 kapuc mbrojtës ka dorëzuar Autorizim datë 09.09.20120 lëshuar nga F-L Gega prodhues i veshjeve njëpërdorimshe mbrojtëse për personel mjekësor ku me anë të kësaj deklaratë deklaronte se Farma Net Albania shpk është i autorizuar eskuzivisht të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me Nr.Ref-65289-07-13-2020 për të paraqitur ofertë , të negociojë dhe të nënshkruajë kontratë për produktet e prodhuara nga kompania jonë si dhe të shpërndajë produktet tona për të gjithë teritorin e Shqipërisë si dhe Certificate Konformiteti lëshuar nga AQScert Sigurimi i cilësisë së prodhimit-Direktiva e pajisjeve medicinale 93/42/EEC shtojca V me numër certificate AQS/DM/50852020 për kompaninë F-L Gega shpk referuar Direktivës

dhe Annex 93/42/EEC Medical Devices Directive-Annex V. Prodhimi i materialeve mbrojtëse njëpërdorimshe për stafin mjekësor (sterile dhe josterile) dhe materiale njëpërdorimshe për kirurgji sterile (sete , beze, përparëse). ASQCERT deklaron se kërkesat e shtojcës V të direktivës 93/42/EEC janë përmbushur për produktet e listuara Prodhimet e lartpërmendura zbatojnë një sistem të sigurimit të cilësisë i cili është subjekt i auditimeve të mbikqyrjes periodike të përcaktuara në shtojcën V, seksioni 4 të direktivës së lartpërmendur.

III.1.8. Lidhur me sa më sipër KPP për një shqyrtim të drejtë dhe transparent të çështjes objekt shqyrtimi lidhur me verifikimin e statusit të subjektit lëshues të certifikatës së konformitetit AQSCERT ju drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit me shkresën nr.1542/3 datë 25.11.2020 me lëndë “*Kërkesë për informacion*” me përmbajtje si vijon:

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konsatojmë se nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, janë paraqitur Certifikata Konformiteti “Për Sigurimin e Cilësisë së Prodhimit”- Direktiva e Paisjeve Mjekësore 93/42 EEC të lëshuara nga AQSCERT.

*Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, nenit 28 pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik, neneve 71, 72,73 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, **KPP ju drejtohet ju si institucion kompetent për një sqarim lidhur me faktin nëse shoqëria AQSCERT është e akredituar për të lëshuar Certifikata Konformiteti CE për paisjet/produkte mjekësore, sipas Direktivës së Paisjeve Mjekësore 93/42 EEC.***

III.1.9. Në datën 25.11.2020 në rrugë elektronike Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit lidhur me kërkesën sa më sipër ka dhënë sqarimet si më poshtë:

- *Lidhur me kerkesen tuaj, ju informojme qe AQSCERT eshte akredituar si Organizem çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të pajisjeve mjekësore në përputhje me ISO/IEC 13485:2016.*
- ***Ai nuk eshte akredituar sipas direktives 93/42/EEC, sepse nje OVK(Organizem Vleresimi Konformiteti) nuk mund te akreditohet sipas nje direktive.***

III.1.10. Sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik Farma Net Albania shpk me dokumentacionin e dorëzuar nuk arrin të përmbushë kriterin e përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi lidhur me paraqitjen e dokumentit Certifikatë konformiteti sipas direktivës MDD 93/42 EEC (të përditësuar) ose sipas normës EU 2016/425, (të përditësuar) ose FDA, për produktet me nr rendor. 5 veshje personale dhe nr rendor.6 kapuc mbrojtës. Mospërmbushja e kriterit konsiston në faktin që subjekti lëshues i certifikatës së konformitetit në rastin konkret AQSCERT nuk mund të lëshojë certifikata konformiteti lidhur me produktin pas vetë ai nuk është një organizëm i akredituar sipas direktivës 93/42/EEC. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se Certifikata e Konformitetit e lëshuar

nuk përmban logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit si edhe subjekti lëshues i certifikatës nuk rezulton në listën e laboratorëve të akredituar, referuar listës publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit duke dëshmuar kështu se nuk ka kompetencë të kryejë teste mbi përpuethshmërinë e produkteve referuar standardeve Evropiane. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik Farma Net Albania shpk ka dështuar në përmbushjen e kriterit sa më sipër pasi ka paraqitur certifikata konformiteti të produktit si më sipër cituar nga një subjekt i paautorizuar dhe jokompetent sikundër AQSCERT .

Në këto kushte KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori Farma Net Albania shpk nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për përmbushjen e kriterit dhe nuk krijon bindjen se produktet e ofertuara prej tij plotësojnë standartet e kërkuara sipas direktivës 93/42/EEC 2016/425, (të përditësuar) ose FDA.

II.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimeus "Intermed" shpk lidhur me operatorin ekonomik "Farma Net Albania" shpk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Intermed" shpk mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "OES Distrimed" shpk dhe "Montal" shpk me argumentin se *Së pari duke qenë se shoqëria jonë ka qenë një shoqëri lider në treg dhe vecanërisht në furnizimin e sektorit privat dhe publik gjatë periudhës së pandemisë me pajisje e masa mbrojtëse si edhe duke patur njohur të thelluara të tregut ngrejme dyshimet tona që shoqëritë e kualifikuara nuk kanë dëshmuar se disponojnë dëshmi të eksperiencës së ngjashme në masën 40 % e vlerës së fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit.*

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të procedurës së prokurimit si dhe kapacitetin e shoqërive të kualifikuara pasi kemi investiguar në bilancet e tyre mbi volumin e shitjeve dhe të ardhurat nga aktiviteti si dhe njohurive që disponojmë nga studimi i tregut e mendojmë të arsyeshme nga ana jonë ngritjen e dyshimeve që asnjë prej tyre nuk disponon kontratë të ngjashme në vlerën e kërkuar", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" pika 2.3. "Kapaciteti teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 40% të fondit limit të kësaj procedure prokurimi., të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.2. Në shtojcën 10 "Specifikimet teknike" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Specifikime	Njesia
1	Cizme plastike mbrojtese	Cizme plastike mbrojtese	<i>Pale</i>
2	<i>Doreza Nitrili madhesia M pa puder</i>	<i>sterile, pa puder ngjyre blu ose lejla me trashesi 0.12 mm (kuti me 100 cope), duhet te jene me te trasha se sa normalet per pune ne laborator Masa M</i>	<i>Kuti</i>
3	<i>Maska respiratore FFP3/FFP2 (N95)</i>	<i>Maske respiratore FFP2 (N95) me nje perdorim, hipoalergjike, pa fibra qelqi, pershkueshmeri te mire te ajrit, me nivel filtrimi te ajrit >= 95%, e perputhshme me fytyren dhe hundën, e certifikuar NIOSH 95 ose te plotesojne EN 149:2001</i>	<i>Cope</i>
4	<i>Syze mbrojtëse</i>	<i>Material polietilen me densitet të lartë, me kornizë fleksibël PVC që përshatet lehtësisht me të gjitha konturet e fytyrës me presion të barabartë, për mbrojtjen e syve dhe zonën përreth tyre, që puthitet me lëkurën e fytyrës, lehtësisht I pastrueshëm, rezistent ndaj gërvishjeve dhe avujve, me shirit rregullues për tu siguruar shtrëngimin në mënyrë që të mos lirohet gjatë veprimtarisë klinike, Të ripërdorshme kundrejt kundrejt ndjekjes së rregullave përkatëse për dekontaminimin. Të jetë në</i>	<i>Cope</i>

		<i>përputhje me EN 166/ ANSI/ISEA Z87.1 ose ekuivalent.</i>	
5	<i>Veshje e padepërtueshme brendshme/jashtme me një përdorim</i>	<i>Veshje personale, jo të endura, me një përdorim, e përbere nga bluza dhe pantallonat. Bluza duhet të jetë me mëngje të shkurtra, pa kopsa ndërsa pantallonat duhet të jenë të gjata deri tek kyçet dhe me lidhese rreth belit.</i>	<i>Cope</i>
6	<i>Kapuc mbulues i kokës, qafës</i>	<i>Perdoret për mbrojtjen e kokës, qafës dhe të supëve. Me një përdorim, rezistent ndaj lëngjeve të ndryshme të trupit. Të garantojë mbrojtje kundër lëngjeve dhe produkteve biologjike dhe kimike të rrezikshme dhe agjentëve viralë dhe mikrobialë. Të jetë lehtësisht e adoptueshme në kokë dhe e palevizueshme. Pjesa e pasme dhe anësore të kapuçit të mbulojë shpatullat. Pjesa e përparme e kapuçit të arrijë deri në pjesën e sipërme të perparës ose kominosheve dhe të jetë e hapur në pjesën e fytyrës.</i>	<i>Cope</i>
7	<i>Kostum veshje spitalore</i>	<i>Veshje komplet me kapuc (kominoshe-tyvek) me masë XL dhe L.</i>	<i>Cope</i>
8	<i>Ekran mbrojtës i fytyrës</i>	<i>Ekran mbrojtës për fytyrën. Materiali i ekranit duhet të lejojë një shikim të qartë, të ketë mundësi rregullimi që të mund të pershtatet dhe ngjeshet mirë me kokën. Të mbulojë plotësisht fytyrën dhe pjesët anësore të saj. Të jetë një përdorimëshme. Të plotësojë standartin EN 166/2002</i>	<i>Cope</i>
9	<i>Doreza të gjata jo sterile, nitrile</i>	<i>Doreza të gjata jo sterile, nitrile me gjatësi jo më pak se 230 mm, me ngjyrë</i>	<i>cope</i>

III.2.3.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatorët ekonomikë “OES Distrimed” shpk dhe BOE “Montal” shpk & “Biometric Albania” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

OES Distrimed shpk

- Kontratë Nr.379/1 prot datë 18.04.2017 lidhur ndërmjet Spitali Universitar Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë dhe BOE Euromed shpk & OES Distrimed me objekt **“Blerje materiale mjekimi konsumabël dhe kirurgjikale”** me vlerë totale të kontratës 26,905,786.64 lekë pa tvsh shoqëruar me vërtetim realizimi. Euromed do të realizojë 12,437,600.64 lekë me tvsh dhe OES Distrimed shpk 14,468,184 lekë me tvsh.
- Kontratë Furnizimi Nr.4, Nr.5112/4 prot datë 07.12.2018 lidhur ndërmjet Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe BOE Euromed shpk dhe OES Distrimed shpk me objekt **MM3-Blerje materiale mjekimi për anestezi reanimacion shiringa dhe age një përdorimshme kirurgjikale”** me vlerë të kontratës 1,707,330 lekë pa tvsh . Operatori Euromed ka vlerën 195,330 lekë pa tvsh, Operatori ekonomik OES Distrimed shpk ka vlerën 1,512.00 lekë pa tvsh.
- Kontratë Furnizimi nr.5 , Nr.5403/4 prot datë 27.12.2018 lidhur ndërmjet Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe BOE Euromed shpk dhe OES Distrimed shpk me objekt **MM3- Materiale mjekimi për anestezi reanimacion shiringa dhe age njëpërdorimshme kirurgjikale**. Operatori OES Distrimed ka vlerën 5,455,500 lekë pa tvsh dhe Euromed shpk ka vlerën 8,349,500 lekë pa tvsh.
- Kontratë Furnizimi 2 Nr.4493/5 prot datë 17.10.2018 lidhur ndërmjet Qendra Spitalore Univessitare Nënë Tereza dhe BOE Euromed shpk dhe OES Distrimed shpk me objekt **MM3- Blerje materiale mjekimi për anestezi reanimacion shiringa dhe age njëpërdorimshme kirurgjikale”**, me vlerë 10,278,250 lekë pa tvsh. OES Distrimed shpk ka vlerën 4,446,050 lekë pa tvsh , Shoqëria Euromed ka vlerën 5,832,200 lekë pa tvsh.
- Kontratë Furnizimi Nr.2, Nr.4494/5 prot datë 17.10.2018 lidhur ndërmjet Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe BOE Euromed shpk dhe OES Distrimed shpk me objekt MM4-Blerje materiale qepse kirurgjikale, dezinfektantë mjekësorë dhe kirurgjikalë” me vlerë 12,557,568.80 lekë pa tvsh. OES Distrimed shpk ka vlerën 7,281,988.80, Euromed shpk ka vlerën 5,275,580 lekë pa tvsh.
- Kontratë Furnizimi Nr.2642/4 prot datë 29.05.2018 lidhur ndërmjet Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe BOE Euromed shpk dhe OES Distrimed shpk me objekt MM4-Blerje materiale qepse kirurgjikale, dezinfektantë mjekësore dhe kirurgjikale me vlerë 12,517,232.80 lekë pa tvsh. Euromed ka vlerën 5,159,740 lekë pa tvsh. OES Distrimed shpk ka vlerën 7,357,492.80 lekë pa tvsh.
- Kontratë Furnizimi Nr.2643/4 prot datë 25.05.2018 lidhur ndërmjet Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe BOE Euromed shpk dhe OES Distrimed shpk me objekt **MM3-Blerje materiale mjekimi për anestezi reanimacion shiringa dhe age**

- njëpërdorimshme kirurgjikale”,** me vlerë 9,877,300 lekë pa tvsh. Euromed 5,698,150 lekë pa tvsh dhe OES Distrimed shpk ka vlerën 4,179,150 lekë pa tvsh.
- Kontratë Furnizimi Mallra nr.2/2018 Materiale Mjekimi MM3, Nr.173/2 prot datë 21.09.20218 lidhur mes Spitali Universitar i Traumës dhe BOE OES Distrimed shpk dhe Euromed shpk me objekt **MM3-Materiale mjekimi për anestezi reanimacion shiringa dhe age njëpërdorimshme kirurgjikale** me vlerë 2,338,170 lekë pa tvsh . OES Distrimed shpk ka vlerën 1,246,835 lekë pa tvsh dhe Euromed shpk ka vlerën 1,091,335 lekë pa tvsh.
 - Kontratë Furnizimi Mallra Materiale Mjekimi MM3 nr.120/2 prot datë 29.05.2018 lidhur ndërmjet Spitali Universitar i Traumës dhe BOE OES Distrimed shpk dhe Euromed shpk me objekt **MM3-Materiale mjekimi për anestezi reanimacion shiringa dhe age njëpërdorimshme kirurgjikale,** me vlerë 4,552,202.1 lekë pa tvsh. OES Distrimed shpk ka vlerën 1,323,834.60 lekë pa tvsh. Euromed shpk ka vlerën 3,228,367.50 lekë pa tvsh.
 - Kontratë Furnizimi Mallra Materiale Mjekimi MM4 nr.121/2 prot datë 29.05.20218 lidhur ndërmjet Spitali Universitar i Traumës dhe BOE OES Distrimed shpk dhe Euromed shpk me objekt **MM4-Materiale qepse kirurgjikale dhe dezinfektantë mjekësorë dhe kirurgjikalë”** me vlerë 7,581,490.52 lekë pa tvsh. OES Distrimed shpk ka vlerën 6,390,062.72 lekë pa tvsh. Euromed shpk ka vlerën 1,191,427.80 lekë pa tvsh.
 - Kontratë Furnizimi Mallra nr.2/2018 Materiale Mjekimi MM4 Nr.174/2 prot datë 21.09.2018 lidhur ndërmjet Spitali Universitar i Traumës dhe BOE OES Distrimed shpk dhe Euromed shpk me objekt **MM4-Materiale qepse kirurgjikale dhe dezinfektantë mjekësorë dhe kirurgjikalë”,** me vlerë 1,317,503.2 lekë pa tvsh. OES Distrimed shpk ka vlerën 767,400 lekë pa tvsh. Euromed shpk ka vlerën 550,103.2 lekë pa tvsh.
 - Kontratë Nr.569/1 prot datë 04.05.2018 lidhur ndërmjet Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë dhe BOE Euromed shpk dhe OES Distrimed shpk me objekt **“MM3-Materiale mjekimi për anestezi reanimacion shiringa dhe age njëpërdorimshme kirurgjikale** me vlerë 4,790,366 lekë pa tvsh . Euromed ka vlerën 3,954,051 lekë pa tvsh. OES Distrimed shpk ka vlerën 836,315 lekë pa tvsh.
